



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.14434/9685 (31139-02832-86-2018) Rregj.Them.  
Data Regjistrimi 05.07.2018

Nr. 3207 (86-2019-3640) Vendimi  
Datë 16.12.2019

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA  
GJYQTAR – Enkelejda METALIAJ (SOFTA)  
GJYQTAR – Bernina KONDI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED] në Tiranë, sot me datë 16.12.2019 shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

**PADITËS:** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar [REDACTED] sh.p.k, me NIPT: [REDACTED] me administrator z. [REDACTED], me adresë: Rr. [REDACTED], Tiranë.

**I PADITUR:** Drejtoria e Doganave, Dega Vlorë

**PERSON I TRETË:** Avokatura e Shtetit, Dega Vlorë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me adresë: Rr. "Sami Frashëri", kati 2, Tiranë.

**OBJEKTI:** Kërkoj kthimin e shumës 3 491 036 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë për pagesë të padetyruar dhe begatimin pa shkak.

**BAZA LIGJORE:** Neni 154 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile, neni 653 dhe 655 të Kodit Civil, neni 34 e në vijim të Kodit Doganor.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr.433,datë 29.03.2018 ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në fakte, prova e në ligj.

2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse në vlerën sikundër parashikohet në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ka paraqitur ankim pala paditëse shoqëria [REDACTED] shpk, në datën 28.05.2018 duke parashtruar shkaqet si më poshtë vijon:

1. Për importet e artikujve veshje dhe këpucë të përdorur të kryera nga Italia nga muaji Nëntor 2011 deri në Tetor të 2013 në zbatim të nenit 34 të K.Doganor pala paditëse ka depozituar pranë palës së paditur gjatë procesit të zhdoganimit të mallit, bashkë me deklaratat Ipm-4 edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin doganor sipas metodës së transaksionit si faturat origjinale, dokumentat e pagesave, deklaratat e ekspertit etj.,

Pavarësisht nga ky dokumentacion i paraqitur pala e paditur ka bërë ndërhyrje në faturë duke e detyruar palën paditëse të paguante edhe detyrim doganor prej 3.491.036 lekë më tepër se sa detyrimi doganor i llogaritur sipas faturave reale të blerjes së mallit.

Për zgjidhjen e këtij problemi pala paditëse i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me shkresën nr.16403 datë 03.10.2013 si dhe palës së paditur me shkresën nr.3370 datë 04.10.2013 që në bazë të nenit 18-20 të K.Doganor të merrej një vendim për zbatimin e legjislacionit doganor duke kërkuar njëkohësisht dhe anulimin e ndërhyrjeve që pala e paditur ka bërë në faturat përkatëse të Deklaratave Doganore Imp-4 të sipërcituar si dhe kthimin e shumës së përgjithshëm të paguar më tepër.

Në përgjigje të kësaj kërkesë pala e paditur na bën me dije nëpërmjet shkresës nr.3370/1 datë 17.10.2013 se *nuk mund të kryejë kthimin e shumës së pretenduar pasi për vlerësimin doganor të mallrave të importit ajo ka proceduar duke zbatuar referencën në bazë të nenit 36 të K.Doganor.*

2. Gjykata në vendimin nr.433, dt 29.03.2018 ka bërë një vlerësim juridik të gabuar, të njëanshëm dhe në keqzbatim të legjislacionit doganor duke moszhvilluar një proces të rregullt ligjor.
3. Në vendimin e saj nr.433, dt 29.03.2018 pika 8.4 Gjykata ka vlerësuar duke arsyetuar se: *"subjekti i palës paditëse ka ankimuar veprimin e organit publik vetëm pranë Degës së Doganës Vlorë pa u ankuar më tej pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me seli në Tiranë... dhe nuk ka shteruar rrugën administrative"*. Ky vlerësim i gjykatës është i pabazuar në prova pasi me shkresën nr.6403 datë 03.10.2013 pala paditëse i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, zgjidhjen me mirëkuptim të këtij problemi.
4. Në vendimin e saj nr.433, dt 29.03.2018 pika 10 Gjykata analizon shkaqet e ekzistencës së pavlefshmërisë absolute e ndryshimin me pavlefshmërinë relative. Ky shqyrtim për themelin e çështjes është i pabazuar në padinë konkrete pasi objekti i saj

është "Kthimin e shumës 3 491 036 lekë për pagesë të padetyruar dhe begatim pa shkak"

5. Sikundër kemi shpjeguar edhe gjatë seancës gjyqësore, pala paditëse nuk është dakort me konkluzionet e këtij eksperti të pasqyruara në fund të aktit për faktin se: *ka bërë verifikimin e disa dokumentave doganore që ndodhen në dosjen gjyqësore ndërkohë që, nuk ka bërë verifikimin e praktikave doganore (20) objekt shqyrtimi që ndodhen pranë palës së paditur. Eksperti nuk ka kontrolluar praktikat doganore objekt shqyrtimi pranë palës së paditur për të verifikuar gjithë dosjen, dokumentacionin e nevojshëm për mënyrën e vlerësimit, për të verifikuar ekzistencën ose jo të shkaqeve ligjore si ka apo jo dyshime e ku i bazon dyshimet e saj, kërkesën për dokumenta shtesë, origjinalitetin e dokumentacionit shoqërues, verifikimet e kryera nga ajo pranë doganës dhe firmës eksportuese, vendimin me shkrim të grupit të vlerësimit për mënyrën e vlerësimit të nevojshme për ligjshmërinë e tij. Në kundërshtim me certifikatën e tij që zotëron me titull "Ekspert Fiskal" ai ka bërë interpretimin e dispozitave ligjore të Kodit Doganor që një vlerësim të tillë mund ta bëjë vetëm një "Ekspert Ligjor" i certifikuar për atë fushë. Konkluzionet e ekspertit fiskal janë të njëanëshme duke bërë që gjykata të ndikohet në zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor, të njëanshëm dhe në shkelje të Parimeve Themelore të Procesit Gjyqësor.*
6. Në vendimin e saj nr.433, dt 29.03.2018 pika 14 Gjykata pranon se: *"Në pamundësi të referimit në indikatorët e mësipërm, i është referuar drejtëpërdrejtë metodës të "çmimit të referencës".* Kjo tregon shkeljet e rënda proceduriale të palës së paditur që kanë ndikuar në dhënien e këtij vendimi të paligjshëm.  
Në të gjithë vlerësimin që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka bërë në vendimin e saj nr.433, dt 29.03.2018 për zgjidhjen juridike të çështjes rezulton se, ajo ka paraqitur disa referenca ligjore të dispozitave të Kodit Doganor të cilat flasin për të kundërtën përse ka konkluduar në këtë vendim gjyqësor dhe nuk ka bërë një arsyetim llogjik dhe ligjor të kësaj çështje për sa kërkohet në objektin e padisë.
7. Sikundër kemi parashtruar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor thelbi i kërkesës në objektin e padisë nga pala paditëse është: *"Kërkoj kthimin e shumës 3 491 036 lekë për pagesë të padetyruar dhe behatim pa shkak si pasojë e zbatimit në kundërshtim të ligjit për vlerësimin doganor ku, nga 0.4 euro/kg që janë përcaktuar në vlerat e faturave origjinale të mallarave të importuar nga Italia, pala e paditur ka zbatuar referencën për 0.8 euro/kg duke u begatuar pa shkak të ligjshëm nga një pagesë e padetyruar në shumën e sipërcituar".* Për vlerësimin doganor, Gjykata në këtë vendim gjyqësor ka cituar nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37 të kodit doganor dhe në mënyrë allogjike ka arsyetuar mbi këto dispozita për faktin se, arsyetimi i saj ka qenë në shkelje të rradhës ligjore për vlerësimin doganor e mallrave të importit e gjatë zhdoganimit të tyre të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara të Kodit Doganor si dhe në aktet e tjera nënligjore pasi:

*Në pikën 1 të nenit 34 të Kodit Doganor është përkufizuar qartë se: Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë”.*

Pala e paditur gjatë procedurës së zhdoganimit për vlerësimin doganor nuk ka respektuar kërkesat e kësaj dispozite duke ndërhyrë në faturat e importit, megjithëse pala paditëse kishte paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në origjinal.

*Në pikën 1 të nenit 35 të Kodit Doganor përcaktohet qartë se: “Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 34 (vlera e transaksionit) ajo duhet të përcaktohet duke ndjekur sipas rradhës paragrafët (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2...”. në pikën 1 të nenit 36 të kodit doganor përcaktohet se: “kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet se në bazë të nenit 34 (vlera e transaksionit) ose nenit 35 ( metoda alternative) ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në Republikën e Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me...”.*

Në kuptim të këtyre dispozitave del qartë se pala e paditur ka shkelur haptazi procedurën për rradhën ligjore e mënyrës së llogaritjes së vlerës doganore për qëllime doganore në të gjitha praktikatat doganore të sipërcituar duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e këtyre dispozitave ligjore, nëpërmjet ndërhyrjes arbitrare në faturat përkatëse për zbatimin e referencës sipas nenit 36 të Kodit Doganor.

Sipas këtyre dispozitave të sipërcituara , pala e paditur mund ta bënte këtë ndërhyrje vetëm atëherë kur nuk është e mundur që vlera doganore e mallrave të përcaktohet në bazë të neneve 34 ose 35 të këtij kodi. *Në kuptim të gjërës “b” të pikës 15/13 të VKM nr.205 datë 13.04.1999 për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor pala e paditur procedon me rivlerësimin e deklaratës doganore vetëm në qoftë se, dispozitat që rregullojnë rregjimin doganor në fjalë rezultojnë, mbi bazën e informacioneve të paplota ose të pasakta.*

Në zbatim të kësaj dispozite për rastin konkret pala e paditur nuk i ka përmendur palës paditëse gjatë kryerjes se procedurës doganore të zhdoganimit ndonjë fakt për dyshime në dokumentacionin e depozituar pranë saj apo që këto dokumenta të jenë të paplota apo i pasaktë më qëllim që të procedoj për vlerësimin e vlerës të deklaruar në deklaratat doganore të sipërcituara.

Në pikën 1 të udhëzimit të M.F nr.25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” është përcaktuar qartë se: *“Me qëllim standartizimitin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit dhe , për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë në zbatim të neneve 34-39 të kodit doganor, procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore fillojnë me pranimin ose jo të vlerës së transaksionit të deklaruar, sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi”.*

- Në zbatim të kësaj pike, pala e paditur nuk i ka shpjeguar palës paditëse gjatë kryerjes së procedurës doganore të zhdoganimit se, cilin indikator ka shkelur, cilin indikator nuk ka plotësuar apo në cilin indikator ka krijuar dyshime të arsyetuar në mënyrë që të evitohet arbitrariteti, abuziviteti dhe pabarazia në zbatim të neneve 34-39 të kodit doganor.
8. Pala e paditur nuk i ka shprehur palës paditëse gjatë procedurës së zhdoganimit të mallrave ndonjë dyshim se, vlera e deklaruar pranë këtij autoriteti doganor nuk përfaqëson shumën totale realisht që duhet paguar e cila ka sjell si pasojë, ndërhyrjen direkt në faturë për vlerësimin doganor dhe zbatimin e nenit 36 të Kodit Doganor. Pala e paditur nuk i ka kërkuar palës paditëse që të paraqiste ndonjë dokument shtesë për dyshime të arsyeshme që mund të kishte tek dokumentacioni i depozituar pranë saj fakt ky që tregon se, ajo ka vepruar në kundërshtim me ligjin doganor për ndërhyrjet në faturë.
9. Të gjitha këto fakte tregojnë se pala e paditur ka përfituar në mënyrë të padrejtë, pa ndonjë shkak dhe në shkelje me ligjin doganor këtë shumë. Në zbatim të nenit 653 për pagesë të padetyruar të Kodit Civil është përcaktuar se: *"Cilido që ka bërë një pagesë të padetyruar, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar, si dhe të gëzojë frytet dhe kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marrë pagesën është në keqbesim, dhe nga dita e kërkesës për kthim, kur personi është në mirëbesim"*.
10. Kjo gjykatë, në arsyetimin e saj në vendimin nr.433, datë 29.03.2018 nuk është shprehur në lidhje me kërkesën e palës paditëse në objektin e kërkesës padisë për bazën ligjore të nenit 655 për begatim pa shkak të Kodit Civil". Sipas kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se: *"Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit"*. Ky fakt tregon se Gjykata ka zhvilluar një proces jo të rregullt gjyqësor, të njëanshëm, në shkelje të parimeve themelore të procesit gjyqësor dhe konkretisht të nenit 6 të K.Pr.Civile sipas së cilës thuhet se: *"Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka dhe vetëm për atë që kërkohet"*. Pala e paditur është begatuar pa shkak dhe në kundërshtim me ligjin doganor për mënyrën e llogaritjes së vlerës doganore për qëllime doganore pasi ka shkelur hapur rradhën ligjore të përcaktuar në nenet 34, 35, 36 e vijim të Kodit Doganor. Ky fakt është pranuar nga gjykata e deklaruar se për vlerësimin doganor ka zbatuar menjëherë nenin 36 të Kodit Doganor dhe jo rradhën ligjore, duke u begatuar pa shkak në shumën 3.491.036 lekë ndërkohë që, sipas përcaktimit të ligjit doganor kjo dispozitë mund të zbatohet vetëm kur vlera doganore e mallrave të importuar që nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 34 e 35 të këtij kodi. Pala e paditur ka ndërhyrë në faturat e importit duke e detyruar palën paditëse të kryej një pagesë të padetyruar ligjërisht në një vlerë totale prej 3.491.036 lekë.

11. Sa sipër pala paditëse përfundimisht kërkon: Ndryshimin dhe prishjen e vendimit nr.433 datë 21.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ngarkimin e palës së paditur me të gjitha shpenzimet gjyqësore.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, pasi dëgjoji relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe pasi analizoi shkaqet e ngritura në ankim, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedurial,

#### VËREN

Se çështja objekt gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit është ankimi ndaj vendimit nr.433, datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me anë të të cilit është shqyrtuar dhe disponuar në lidhje me kërkesë padinë e paditësit Shoqëria "ROGI-2001" shpk me objekt, bazë ligjore dhe palë ndërgjyqëse siç përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Pala paditëse fillimisht i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 03.02.2014 .

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.1049 datë 19.06.2014 ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit shoqëria "██████████" shpk si të pabazuar në ligj e në prova".

Kundër këtij vendimi rezulton të jetë ushtruar ankim nga pala paditëse në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj nr.370 datë 24.03.2015 ka vendosur: "Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e kësaj çështje civile dhe dërgimin për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë".

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr.3704 datë 14.09.2017 ka vendosur: "Prishjen e vendimit nr.1049 datë 19.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.433, datë 29.03.2018 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë-padisë si të pabazuar në fakte, prova e në ligj.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur ankim pala paditëse brenda afatit ligjor.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala paditëse është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi janë verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

#### Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr.433, datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

Shoqëria [REDAKTUAR] shpk është një subjekt tregtar i organizuar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar i cili ushtron aktivitetin tregtar në fushën e *"...tregtimit me pakicë dhe më shumicë të vajrave, lubrifikantëve, pjesë makinash, rroba të përdorura..."*.

Gjatë importimit të mallrave nga Italia për periudhën Nëntor 2011- Tetor 2013, kryesisht veshje dhe këpucë të përdorura, duke hartuar gjithsej 18 praktika doganore, organi publik Drejtoria e Doganës Vlorë ka aplikuar gabim metodën e vlerësimit doganor.

Si rrjedhim subjekti i palës paditëse kërkon marrjen e një vendimi nga ana e organit publik për anulimin e përllogaritjes së vlerësimit doganor dhe kthimin e shumës 3 491 036 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë.

Ky pretendim i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Doganës, Dega Vlorë, me anë të shkresës me lëndë "Për anulimin e vlerësimit doganor të kryer nga Dega e Doganës Vlorë për importet e kryera si dhe kthimin e shumës 2 650 247 lekë që është paguar tepër", me nr.3370 prot., datë 17.10.2013.

Dega e Doganës Vlorë me anë të shkresës "Kthim përgjigje" me nr.3370/1 prot, datë 17.10.2013 ka refuzuar pretendimin e palës paditëse, më argumentin se, ky organ ka zbatuar çmimet referenciale në zhdoganimin e mallrave të tij, duke iu referuar nenit 36 të Kodit Doganor me anë të *"metodës së zgjedhjes më të mirë dhe kufizimet"*, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.04.1999 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.1, datë 25.01.2006 "Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore". Sipas organit publik, çmim sipas metodës *"së zgjedhjes më të mirë dhe kufizimet"*, bazuar në legjislacionin e mësipërm është i zbatueshëm për mallin "veshje e përdorur" përveç rasteve kur çmimi i deklaruar është më i madh se çmimi referencial.

Në këto rrethana, subjekti paditës, duke pretenduar se e ka ezauruar rrugën administrative, i është drejtuar me kërkesë padi fillimisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë , e pasi çështja është rikthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, i është ridrejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me pretendimin për kthimin e shumës të paguar pa të drejtë, duke kërkuar prej Gjykatës të konsiderojë shumën prej 3 491 036 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë si një bëgatim pa shkak të kryer nga pala e paditur përkundrejt subjektit të palës së paditur.

Gjatë gjyqimit në gjykatën e shkallës së parë është kryer një akt ekspertimi nga eksperti fiskal Edmond Ferraj. Nga akti i ekspertimit është konkluduar se: *Detyrimi doganor për mallrat dhe këpucë të përdorura të deklaruara nga subjekti ROGI-2001 me deklaratat doganore të mësipërme për periudhën Nëntor 2011 deri në Tetor të vitit 2013 kur për vlerësimin e mallrave është aplikuar metoda e vlerësimit me transaksion është 4.686.408 lekë. Detyrimi doganor për mallrat veshje dhe këpucë të përdorura të deklaruara nga subjekti [REDAKTUAR] me deklaratat doganore të mësipërme për periudhën Nëntor 2011 deri në Tetor të vitit 2013 ku për vlerësimin e mallrave është aplikuar, metoda e vlerësimit me referencë është 7.831.153 lekë.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr.433, datë 29.03.2018 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në fakte, prova e në ligj.

Nga përmbajtja e vendimit nr.433, datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Neni 250 të KVD-së, ndër të tjera sanksionon se, rimbursimi për pagesat e kryera mbi vlerën e caktuar mund të kërkohe brenda afatit, me kërkesë drejtuar organit kompetent për anulimin e deklaratës doganore. Nga ana tjetër neni 19-20 të KVD –së parashikojnë ankimin në organin më të lartë administrativ në fushën e doganave, sikundër është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kundër vendimeve të ndërmarra në interes të kundërt të individëve.

Duke u rikthyer tek çështja konkrete rezulton se, subjekti i palës paditëse ka ankimuar veprimin e organit publik vetëm pranë Drejtorisë së Doganës Vlorë, pa u ankuar më tej pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me seli në Tiranë. Pa parashtruar ankimin pranë organit më të lartë administrativ, pala paditëse ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky fakt tregon se, subjekti paditës nuk e ka shteruar rrugën administrative përpara se të ngrinte padi e si rrjedhim, padia për çdo pretendim të tillë duhet të mospranohet për shqyrtim në përputhje me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5 datë 30.10.2012.

2. Në lidhje me shqyrtimin në themel të pretendimeve. Gjykata pasi mori në shqyrtim të gjitha faktet dhe provat e debatuar gjatë hetimit gjyqësor vlerëson se, pretendimet e kërkesëpadisë duhet të rrëzohen plotësisht pasi nuk mbështeten në fakte, prova e në ligj. Arsyet e një qëndrimi të tillë nga ana e Gjykatës argumentohen si në vijim. Kushti i domosdoshëm që një akt administrativ të krijojë efektet juridike është vlefshmëria e tij. Ligji detyron organet e administratës publike të respektojnë urdhërimet e tij, me qëllim që aktet e nxjerra prej tyre të sjellin pasojat e dëshiruara ligjore. Mosrespektimi apo injorimi i këtyre urdhrave pasjellin pasojën e paligjshmërisë së aktit. Mjafton shkelja e njëres prej tyre për të zhvlerëzuar aktin në tërësinë e tij. Elementët e vlefshmërisë së aktit administrativ janë katër. Ato janë: 1- *Kompetenca ( neni 21 e në vijim i KPA-së);* 2- *Procedura ( neni 46 e në vijim i KPA-së);* 3- *përputhja e aktit me përmbajtjen e ligjit ( neni 9 i KPA-së;* 4- *përputhja e aktit me qëllimin e ligjit ( neni 107 të KPA-së).* (1.a). Me kompetencë kuptohet e drejta dhe detyra e një organi të administratës publike për të ushtruar veprimtari në bazë dhe për zbatim të ligjit. (ii.a).Procedura që duhet të ndiqet për nxjerrjen e një akti administrativ përcaktohet nga natyra dhe forma e aktit, si dhe nga struktura dhe vendi që zë organi administrativ në sistemin e përgjithshëm të hierarkisë shtetërore. Ajo ndahet në tri faza. Në procedurën paraprake, në procedurën gjatë nxjerrjes së



aktit dhe procedura pas nxjerrjes së aktit. Të gjitha këto faza proceduriale duhet të respektohen, për aq sa ligji i posaçëm nuk ka parashikuar ndryshe. Në rast të kundërt akti administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këto faza proceduriale bëhet i pavlefshëm. (iii.a) Karakteri nënligjor i aktit administrativ është një ndër veçoritë e tij kryesore. Ai duhet t'i referohet në çdo rast kërkesave të ligjit me qëllim që në asnjë rast mos të vijë në kundërshtim apo ta tejkalojë atë. (iv.a) Nëpërmjet aktit administrativ realizohet krijimi, ndryshimi apo shuarja e një marrdhënie juridike të caktuar. Pikërisht, ky qëllim, që kërkohet të arrihet nëpërmjet aktit administrativ duhet domosdoshëmsht të përputhet me qëllimin e vetë ligjit. Të katër elementët që karakterizojnë vlefshmërinë e aktit administrativ kanë rëndësi përcaktuese për të vlerësuar ligjshmërinë e tij. Asnjë prej këtyre kriterëve nuk mund të marrë përparësi për arsye të konkurimit me njëri tjetrin. Mosrespektimi i këtyre kriterëve /elementëve të vlefshmërisë së aktit pasjellin pavlefshmërinë e tij, e cila për nga forma e rëndësisë së shkeljes ndahet në pavlefshmëri absolute dhe pavlefshmëri relative (anullim/ shfuqizim).

3. Duke u rikthyer tek çështjes konkrete, pala paditëse kërkon prej gjykatës që të detyrojë organin publik, Drejtorinë e Doganave, Dega Vlorë për të bërë kthimin e të gjithë të ardhurave të marra sipas tij në mënyrë të padrejtë, duke aplikuar tarifa zhdoganimi më të mëdhaja se, ato që ishin parashikuar në deklaratimet e tij.  
Gjykata vlerëson se, në rastin konkret nuk ndodhemi përpara rastit të paligjshmërisë së veprimeve administrative të ndërmarra nga organi publik DD Vlorë, e si rrjedhim pretendimi i palës paditëse duhet të rrëzohet. Kjo për arsye se, organi administrativ në nxjerrjen e akteve administrative përkatëse ka respektuar të katërta kriteret e vlefshmërisë së aktit administrativ.
4. Kodi i Vjetër Doganor në nenin 34 të tij parashikon dy mënyra se si mund të zhdoganohen mallrat e importuar. Ato janë duke iu (i) referuar çmimit real të paguar nga importuesi ose (ii) çmimi që duhet të paguhej normalisht për mallra të tillë. Më tej bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave me nr.25, datë 30.11.2007 "*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimit të informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes...*", në seksionin 1/1, 2, 3, 4, 5 të tij, i njihet e drejta e organeve tatimore që bazuar në indikatorët e parashikuar në këtë akt nënligjor, të vlerësojnë transaksionin e importit në vlerë të ndryshme nga ajo që është deklaruar nga individit. Që të arrihet në këtë konkluzion, duhet detyrimsht që organi publik, DD Vlorë të përmbushë kriteret si në vijim: (i) Duhet të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm se deklarimi nuk jep çmimin e drejtë të blerjes/shitjes; (ii) subjekti deklarues, me qëllim bërjen e deklaratimit të tij të besueshëm përpara organit publik, duhet ti bashkëlidh deklaratimit të tij edhe disa nga indikatorët e parashikuar në Udhëzimin nr.25/2007 të Ministrisë të Financave, si për shëmbull vlera e produktit nuk mund të jetë më e ulët se lënda e parë, vendi i origjinës me rrisht: Azisë, Lindjes së Largët, Vendeve Arabe,

zonave të lira, (zona off-shore), Amerika Latine; në vendin e deklaruar si origjinë malli i deklaruar nuk prodhohet etj; (iii) kur dështon aplikimi i një çmimi sipas indikatorëve të mësipërm, zbatohen çmimet referenciale (paragrafi 4-5 i Sesioni 1 të udhëzimit). Për sa u parashtrua më sipër, është pushtet diskrecional i organit publik (DD Vlorë), të aplikojë një nga dy mënyrat e përcaktimit të çmimeve, të cilët do të zbatohen mbi mallrat për efekt importimi. Ose të aplikojë çmimin e deklaruar nga importuesi, ose t'i caktojë sendit një çmim tjetër sipas një hetimi të mirfilltë administrativ, duke zbatuar me rigorozitet kriteret e mësipërme.

5. Në rastin konkret rezulton se, kriteret e mësipërme ligjore dhe nënligjore janë zbatuar me përpikmëri në rastin konkret. Kjo pasi (i) organi publik kishte një dyshim të arsyeshëm për një deklarim të pavërtetë nga subjekti paditës dhe ky u vërtetua kur nxorri një diferencë në çmim deri në 3 400 000 lekë; (ii) organi publik në pamundësi të referimit në indikatorët e mësipërm, i është referuar drejtëpërdrejtë metodës të "çmimit të referencës", e cila nuk është asgjë tjetër, por vetëm aplikimi i një çmimi standard për mallra të ndryshëm, çmimi i të cilës është më i lartë se ai i mallit të deklaruar nga individi.
6. Në kuadrin e një hetimi të plotë gjykata caktoi një ekspert të pavaruar kontabilist, të cilit iu lanë, ndër të tjera, dy detyra kryesore, aplikimi i detyrimeve doganore sipas çmimit të mallit të deklaruar nga subjekti dhe aplikimi i detyrimit doganor sipas çmimeve referenciale zyrtare (veshje të përdorura -0.8 euro për kilogram). Sipas aktit të ekspertimit, diferenca në çmimin e detyrimit doganor sipas deklarimeve të palës paditëse dhe çmimeve referenciale të aplikuara nga Drejtoria e Doganës Vlorë për periudhën Nëntor 2011- Tetor 2013 është 3 144 745 (tre milion e njëqind e dyzet e latër mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë (paragrafi 3, fq 24 i aktit). Për sa më sipër gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të palës paditëse për padrejtësi në aplikimin e tarifave ndaj mallrave të importuar prej tij duhet të rrëzohet edhe bazuar në këtë argument si i pambështetur në fakte e në prova.
7. Si konkluzion gjykata pasi mori në shqyrtim në tërësi faktet e parashtruara prej saj në gjykim, pasi debatoi provat, e më pas i administroi ato vendosi të rrëzojë themelësinë e pretendimeve të kërkesëpadisë pasi ato nuk bazoheshin në fakte, prova e në ligj.
8. Gjkata përpara se të shpallë dispozitivin e këtij vendimi gjyqësor, hetoi edhe për shpenzimet gjyqësore të këtij procesi. Nga aktet e dosjes rezultoi se, paditësi ka parapaguar taksën e padisë në vlerën e 3 000 (tre mijë) lekë si dhe 31 900 (tridhjetë e një mijë e nëntëqind) lekë si 1% e pretendimit të kërkuar në kërkesë padi konform Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë Ministrit të Financave nr.33 datë 29.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Notërisë". Pala paditëse parapagoi ekspertin z. [REDAKTUAR] në vlerën e 40 000 (dyzet mijë) lekëve, sipas Faturës së Thjeshtë Tatimore me numër serie 11568255, me nr.5 datë

16.03.2018. janë hartuar nga gjykata nën koston e saj 30 fletëthirrje në vlerën totale 3600 (tremijë e gjashtëqind) lekëve. Vlera e përgjithshme e shpenzimeve gjyqësore është 78 500 (shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekëve. Gjykata vlerëson se shpenzimet gjyqësore në vlerën tërësore të tyre duhet t' ngarkohen palës paditëse. Kjo vjen si rrjedhojë e rrëzimit të plotë të kërkesëpadisë. Në momentin e ekzekutimit, 3 600 (tremijë e gjashtëqind) duhet të kalojnë për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë si shpenzime për njoftimin e palëve në gjykim.

9. Përfundimisht gjykata, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi analizoi rrethanat e faktit, mori, vlerësoj dhe administroi provat, pasi dëgjoj pretendimet e subjektit paditës, prapësimet e palës së paditur e argumentat e personave të tretë, si dhe pasi bëri një interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të zbatueshme në rastin konkret, vlerëson se pretendimet e kërkesëpadisë duhet të rrëzohen plotësisht.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur ankim pala paditëse duke kërkuar ndryshimin dhe prishjen e vendimit nr.433 datë 21.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

#### Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit të palës paditëse, shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit objekt ankimi, të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: vendimi nr. 433, datë 29.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është marrë në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit çmon të analizojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala paditëse si dhe kuadrin ligjor i cili rregullon mosmarrveshjen objekt gjykimi.

Së pari: Në çështjen objekt shqyrtimi, rezulton se pala paditëse shoqëria [REDAKTUAR] shpk kërkon nga Gjykata që të detyrojë organin publik Drejtorinë e Doganave, Dega Vlorë për kthimin e shumës 3 491 036 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tridhjetë e gjashtë), pasi sipas tij kjo vlerë është marrë në mënyrë të padrejtë duke aplikuar tarifa zhdoganimi më të mëdha se ato që ishin parashikuara në deklaratimet e tij.

Rezulton e provuar se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka rrëzuar padinë e paditësit duke argumentuar se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara rastit të paligjshmërisë së veprimeve administrative të ndërmarra nga organi publik Drejtoria e Doganave, Dega Vlorë e si rrjedhim pretendimi i palës paditëse duhet të rrëzohet.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se një konkluzion i tillë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është i bazuar në ligj dhe si i tillë është i pranueshëm. Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analizë të plotë e të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit që janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analizë rezulton të jetë plotësisht

e bazuar në kriteret e dispozitave përkatëse të përmendura në vendim, lidhur me përcaktimin e saktë të metodës së vlerësimit doganor sipas nenit 36 të K.Dogonor i cili ka qënë në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve administrative, kjo dhe sipas nenit 37 të ligjit nr.49/2012 ku përcaktohet se *gjkata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.* Gjithashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, drejt dhe në përputhje me ligjin ka konkluduar se, është pushtet diskrecional i organit publik (DDVlorë) të aplikojë një nga dy mënyrat e përcaktimit të çmimeve të cilët do të zbatohen mbi mallrat për efekt importimi. Ose të aplikojë çmimin e deklaruar nga importuesi ose t'i caktojë sendit një çmim tjetër sipas një hetimi të mirëfilltë administrativ, duke zbatuar me rigorizitet kriteret e mësipërme. Gjithashtu, Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, kriteret e mësipërme ligjore dhe nënligjore janë zbatuar me përpikmëri në rastin konkret. Kjo pasi (i) organi publik kishte një dyshim të arsyeshëm për një deklaram të pavërtetë nga subjekti paditës dhe ky u vërtetua kur nxorri një diferencë në çmim (ii) organi publik në pamundësi të referimit në indikatorët e mësipërm i është referuar drejtpërdrejtë metodës së *“çmimit të referencës”* e cila nuk është asgjë tjetër, por vetëm aplikimi i një çmimi standart për mallra të ndryshëm, çmimi i të cilës është më i lartë se ai i mallit të deklaruar nga individi.

Së dyti: Pala paditëse në ankimin e ngritur përpara Gjykatës Administrative të Apelit ka parashtruar se: *“Pavarësisht dokumentacionit të paraqitur nga pala e paditur ka detyruar palën paditëse të paguante edhe detyrimin doganor prej 3.4914.036 lekë më tepër se sa detyrimi doganor i llogaritur sipas faturave reale të blerjes”.*

Për të bërë vlerësimin e këtij pretendimi, Gjykata Administrative e Apelit, i referohet përcaktimeve të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” si dhe VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar.

Konkretisht referuar nenit 8 pika 17 i ligjit nr.8449/2009 përcaktohet se:

*“...17. “Deklarim ne dogane” do te thotë: akti me te cilin një person shpreh, ne format dhe mënyrat e caktuara, vullnetin për te vendosur mallrat nen një regjim te caktuar doganor”.*

Në nenin 33 të Kodit Doganor përcaktohet se: *“Dispozitat e këtij Kreu përcaktojnë vlerën doganore të mallrave për qëllim të zbatimit të Tarifës Doganore të Republikës së Shqipërisë si dhe të masave jo tarifore të parashikuara nga dispozita të tjera që rregullojnë fusha të veçanta që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave”.*

Në nenin 34 të tij përcaktohet se: *“Vlera doganore e mallrave te importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet që mund t'i bëhen në përputhje me nenet 37 dhe 38, me kusht që:*

*a) nuk ekziston asnjë kufizim për tjetërsimin ose përdorimin e mallrave nga blerësi, përveç kufizimeve që:*

- i) janë vendosur ose parashikuar me ligj ose nga autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë,*
- ii) nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në vlerën e mallrave.*
- b) shitja ose çmimi nuk janë objekt i kushteve ose shqyrtimeve, për shkak të të cilave nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave që duhen vlerësuar;*
- c) asnjë pjesë e të ardhurave të nxjerra nga çdo rishitje, tjetërsim ose përdorim i mëvonshëm i mallrave nga blerësi, të mos i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përveç rastit kur mund të bëhet një rregullim i duhur në përputhje me nenin 37; dhe*
- d) blerësi dhe shitësi nuk janë të lidhur, ose kur blerësi dhe shitësi janë të lidhur, vlera e transaktuar të jetë e pranueshme për qëllime doganore sipas paragrafit 2.*
- 2.a) Për të përcaktuar nëse vlera e transaktuar është e pranueshme për qëllimet e paragrafit 1, fakti që blerësi dhe shitësi janë të lidhur nuk përfaqëson në vetvete një arsye të mjaftueshme për ta konsideruar vlerën e transaktuar të papranueshme. Nëse është e nevojshme, shqyrtohen rrethanat e shitjes dhe pranohet vlera e transaktuar, me kusht që lidhja të mos ketë ndikuar në çmim. Nëse, në bazë të informacionit të dhënë nga deklaruesi ose të marrë nga burime të tjera, autoritetet doganore kanë arsye të mendojnë që kjo lidhje ka ndikuar në çmim, ata i komunikojnë arsyet deklaruesit, të cilit i jepet një mundësi e arsyeshme për t'u përgjigjur. Me kërkesë të deklaruesit, arsyet njoftohen me shkrim.*
- b) Në një shitje mes personash të lidhur, vlera e transaktuar pranohet dhe mallrat vlerësohen në përputhje me paragrafin 1, vetëm kur deklaruesi provon që kjo vlerë i për afrohet shumë njëres prej vlerave të mëposhtme, që ekzistojnë në të njëjtën ose përafërsisht në të njëjtën kohë:*
- i) vlerës së transaktuar në rast shitjeje të mallrave identikë ose të ngjashme për eksport drejt Republikës së Shqipërisë, midis blerësve dhe shitësve që nuk janë të lidhur në asnjë rast,*
- ii) vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet në nenin 35(2) (c),*
- iii) vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet në nenin 35(2)(d).*
- Në zbatimin e kriterëve të sipërpërmendura, duhet të mbahen parasysht diferencat që lidhen me nivelet tregtare, nivelet sasiore, elementet e renditura në nenin 37 dhe shpenzimet e bëra nga shitësi në ato shitje, në të cilat ai dhe blerësi nuk janë të lidhur, nëse keto shpenzime nuk janë bërë nga shitësi në shitje në të cilat shitësi dhe blerësi janë të lidhur.*
- c) Kriteret e vendosura në nënparagrafin (b) përdoren me kërkesë të deklaruesit dhe vetëm për qëllime krahasimi. Nuk mund të vendosen vlera zëvendësuese sipas nënparagrafit në fjalë.*
- 3.a) Çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin, ose në dobi të këtij të fundit dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara, nga blerësi shitësit, ose nga blerësi një pale të tretë, për të shlyer një detyrim të shitësit. Pagesa mund të mos bëhet me doemos në formën e transferimit të parave. Pagesa*

*mund të bëhet me anë të letrave te kredisë ose çdo mjete tjetër te rënë dakort, dhe mund të bëhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi.*

*b) Veprimtaritë, duke përfshirë edhe veprimtaritë e marketingut, që ndërmerren nga blerësi për llogari të vet dhe që janë të ndryshme nga ato për të cilat neni 37 parashikon një rregullim, nuk konsiderohen se janë një pagesë e tërthortë që i bëhet shitësit, edhe pse mund të konsiderohen se janë në përfitim të shitësit ose janë ndërmarrë në marrëveshje me shitësin, dhe kostoja e tyre nuk i shtohet çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar në përcaktimin e vlerës doganore të mallrave të importuara.”.*

*Në nenin 35 të Kodit Doganor përcaktohet se: “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 34, ajo duhet të përcaktohet duke ndjekur sipas radhës nënparagrafët (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke u ndalur në të parin nënparagraf që lejon përcaktimin e saj, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e zbatimit të nënparagrafëve (c) dhe (d) mund edhe të shkëmbehet, nëse këtë e kërkon deklaruesi; dhe vetëm në rast se kjo vlerë nuk mund të përcaktohet në bazë të një nënparagrafi të caktuar, lejohet të zbatohen dispozitat e nënparagrafit që vjen menjëherë pas tij sipas radhës që përshkruhet më sipër në këtë paragraf.”*

*2. Vlera doganore e përcaktuar sipas këtij neni do të jetë:*

*a) vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;*

*b) vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;*

*c) vlera e bazuar në çmimin për njësi, në të cilin mallrat e importuara që u korrespondojnë mallrave identike ose të ngjashme të importuara dhe të shitura brenda Republikës së Shqipërisë në sasinë më të madhe të përgjithshme, personave jo të lidhur me shitësit;*

*d) vlera e përlllogaritur e përbërë nga mbledhja e:*

*i) koston ose vlerës së materialeve e të fabrikimit ose të çdo përpunimi tjetër të përdorur për prodhimin e mallrave të importuara,*

*ii) shumës së fitimit dhe të shpenzimeve të përgjithshme, që ka bërë prodhuesi në vendin e eksportimit për t'i eksportuar në drejtim të Republikës së Shqipërisë, që janë të barabarta me shumat që zakonisht rezultojnë nga shitja e mallrave të së njëjtës kategori ose lloj me mallrat që po vlerësohen,*

*iii) koston ose vlerës së elementëve të përmendur në nenin 37(1)(e).*

*3. Rregulla të mëtejshme për zbatimin e paragrafit 2 të sipërpërmendur do të përcaktohen në aktet nëligjore në zbatim të këtij Kodi.*

*Po kështu në nenin 36 të këtij Kodi parashikohet se: “Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 34 ose 35, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në Republikën e Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me:*

a) Marrëveshjen për zbatimin e nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë;

b) nenin 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë;

c) dispozitat e këtij Kreu.

2. Në rastet kur zbatohet paragrafit 1 vlera doganore nuk mund të përcaktohet mbi bazën e:

a) çmimit të shitjes në Republikën e Shqipërisë të mallrave të prodhuara në Republikën e Shqipërisë;

b) një sistemi, i cili, për qëllime doganore, parashikon pranimin e vlerës më të lartë midis dy vlerave alternative;

c) çmimit të mallrave në tregun e brendshëm të vendit eksportues;

d) kostos së prodhimit, të ndryshme nga vlerat e përlllogaritura e të përcaktuara për mallra identike ose të ngjashme, në përputhje me nenin 35(2)(d);

e) çmimeve për eksport drejt një vendi tjetër të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë;

f) vlerave doganore minimale; ose

g) vlerave arbitrare ose fiktive.

Sikundër u cituar më sipër nga aktet në dosjen gjyqësore rezultoi e provuar se: Nga ana e shoqërisë Shoqërisë "ROGI-2001" shpk në periudhën Nëntor 2011- Tetor 2013 ka importuar "veshje dhe këpucë të përdorura" kryesisht nga shtetit Italian duke plotësuar praktikat doganore pranë palës së paditur Dega e Doganës Vlorë, konkretisht: Deklaratën Dog Imp-4 nr.1543 datë 24.11.2011; Deklaratën Dog Imp-4 nr.12484 datë 14.12.2011; Deklaratën Dog Imp-4 nr.13503 datë 09.03.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.22823 datë 23.04.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.6034 datë 16.05.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.8412 datë 07.07.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.10941 datë 07.09.2014; Deklaratën Dog Imp-4 nr.11887 datë 27.09.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.13236 datë 15.11.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.14281 datë 15.11.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.15360 datë 07.12.2012; Deklaratën Dog Imp-4 nr.765 datë 19.01.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.1852 datë 08.02.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.3702 datë 20.03.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.5709 datë 27.04.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.7579 datë 31.05.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.9922 datë 09.07.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.12953 datë 05.09.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.14236 datë 28.09.2013; Deklaratën Dog Imp-4 nr.15731 datë 26.10.2013.

Pala paditëse ka pretenduar se është detyruar nga pala e paditur të paguante detyrim doganor më tepër sa sa detyrimi doganor i llogaritur sipas faturave reale të blerjes së mallit. Për zgjidhjen me mirëkuptim të këtij problemi pala paditëse i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave anulimin e ndërhyrjeve në fatura të kryer nga pala e paditur për Deklaratat Doganore Imp-4 të sipërcituar si dhe kthimin e shumës së përgjithshme të paguar më tepër. Në përgjigje të kësaj kërkesë pala e paditur Dega e Doganës Vlorë me shkresën nr.3370/1 prot datë 17.10.2013 bën me dije se se, nuk mund të kryejë kthimin e shumës së pretenduar pasi për vlerësimin doganor të mallrave të importit ajo ka proceduar duke zbatuar referencën në bazë të nenit 36 të K.Doganor. Një vlerësim i tillë i bërë nga pala e paditur Dega

e Doganës Vlorë në rastin konkret është i bazuar në ligj e si i tillë është i pranueshëm. Gjykata Administrative e Apelit, çmon se për vetë natyrën e mallit që është një mall që në origjinë nuk kryhen transaksione pasi janë veshje të përdorura që janë të falura dhe jo të blera, vlera e shënuar në faturën e shitjes nuk mund të merret për bazë në llogaritjen e vlerës doganore pasi nuk ka një çmim fillestar që është prodhuar dhe shitur ky produkt. Është në vlerësimin e organit doganor që nëse nuk bindet për vlerën doganore të llogarisë atë në përputhje me mënyrat e përcaktuara në Kodin Doganor dhe një ndër këto mënyra është dhe çmimi i referencës sipas nenit 36 të K.Doganor, siç me të drejtë Dega e Doganës Vlorë e ka përdorur në llogaritjen e kësaj vlere doganore.

Së treti: Pala paditëse ka pretenduar se, *“pala e paditur nuk i ka kërkuar palës paditëse që të paraqiste ndonjë dokument shtesë për dyshime të arsyeshme që mund të kishte tek dokumentacioni i depozituar pranë saj, fakt ky që tregon se ajo ka vepruar në kundërshtim me ligjin doganor për ndërhyrjet në faturë”*.

Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Administrative e Apelit çmon se, Kodi Doganor dhe aktet nënligjore të tij kanë parashikuar një procedurë të plotë dhe specifike për të ndjekur, rastet e rivlerësimit dhe kundërshtimit të vlerës doganore të zbatuar nga autoriteti doganor gjatë zhdoganimit të mallit.

Në Kodin Doganor, në nenin 34-36 dhe pika 81 e VKM nr. 205, datë 13.04.1999, i ndryshuar me VKM nr.686, datë 02.11.2005 (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor) janë përcaktuar 6 metodat për vlerësimin doganor në bazë të të cilave pranohet çmimi real i blerjes të artikullit të deklaruar dhe zhdoganuara në doganë.

Në nenin 34 të K.Doganor si vlerë transaksioni përcaktohet çmimi real i blerjes dhe jo çmimi i faturës duke përfshirë këtu koston e transportit dhe siguracionin. Autoritetet doganore nuk duhet të përcaktojnë vlerën doganore të mallrave të importuara mbi bazën e metodës së vlerës së transaktuar, në qoftë se në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 2 ata nuk binden, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme, se vlera e deklaruar përfaqëson shumën totale realisht të paguar ose që duhet paguar sipas nenit 34 të Kodit. Kur autoritetet doganore kanë dyshimet e përmendura në paragrafin 1, të pikës 81 të VKM-së nr. 205/1999 ata mund të kërkojnë informacion shtesë në përputhje me paragrafin 3. Nëse përsëri ka dyshime, autoritetet doganore përpara se të marrin një vendim përfundimtar duhet të lajmërojnë personin e interesuar, me shkrim, në qoftë se ai e kërkon një gjë të tillë, për arsyet që çojnë në dyshime dhe t'i japin atij mundësinë reale për t'u përgjigjur. Vendimi përfundimtar dhe arsyet për marrjen e një vendimi të tillë i komunikohen me shkrim personit në fjalë. Ndërkohë neni 36 i Kodit Doganor i referohet në përmbajtjen e tij dhe marrëveshjes për zbatimin e nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregëtinë (GATT), në të cilën Shqipëria është palë, ku përcaktohet edhe se kush mund të përdoret si vlerë për qëllime doganore. Vlera doganore bazohet në vlerën aktuale të mallrave. Vlera aktuale duhet të jetë çmimi i cili në një kohë dhe vënd të caktuar nga legjislacioni i vendit të importimit, malli i njëjtë ose i ngjashëm është shitur ose ofruar për shitje në



zhvillimin e zakonshëm të tregëtisë dhe në kushte të plota konkurruese. Ligjvënësi duke parë kompleksitetin e përcaktimit të vlerës doganore, ia ka lënë organit doganor përcaktimin e saktë të saj, duke u nisur nga bindja që krijohet mbi bazën e dokumentave të paraqitura.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, procedurat e kundërshtimit të vlerës doganore të zbatuar nga autoriteti doganor gjatë zhdoganimit të mallit, janë të përcaktuara në dispozitat ligjore të Kodit Doganor dhe pikës 81 të dispozitave zbatuese të tij, procedura këto që nuk janë ndjekur nga ana e palës paditëse në rastin konkret, pasi prej saj deklaratat doganore janë pranuar dhe janë likuiduar, kështu që pala e paditur nuk ka nxjerrë ndonjë vendim i cili më pas të mund të kundërshtohet në rrugë administrative e pastaj gjyqësore lidhur me vlerën sikurse parashikohet në nenin 81 të VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999, e ndryshuar me VKM 686, datë 02.11.2005 (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).

Në këtë kuptim pretendimi i palës paditëse se, *pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin doganor për ndërhyrjet në faturë*, është një pretendim i pabazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë i papranuëshëm, siç me të drejtë ka vlerësuar dhe gjykata e shkallës së parë në vendimin objekt ankimi.

Së katërti: Gjithashtu, në lidhje me diferencën në çmimin e detyrimit doganor sipas deklarimeve të palës paditëse dhe çmimeve referenciale të aplikuara nga pala e paditur Dega e Doganës, Dega Vlorë rezulton se gjatë gjykimit në shkallë të parë është marrë prova me ekspertin sipas të cilit ka rezultuar se: *"...diferenca në çmimin e detyrimit doganor sipas deklarimeve të palës paditëse dhe çmimeve referenciale të aplikuara nga Drejtoria e Doganës Vlorë për periudhën Nëntor 2011- Tetor 2013 është 3 144 745 (tre milion e njëqind e dyzet e latër mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë (paragrafi 3, fq 24 i aktit)*. Në këtë kuptim me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, pretendimi i subjektit të palës paditëse për padrejtësi në aplikimin e tarifave ndaj mallrave të importuar prej tij duhet të rrëzohet si i pambështetur në fakte e në prova.

Së pesti: Pala paditëse në ankimin e tij ka pretenduar se *"Pala e paditur Dega e Doganës Vlorë është begatuar pa shkak dhe në kundërshtim me ligjin doganor për mënyrën e llogaritjes së vlerës doganore për qëllime doganore"*.

Në lidhje me këtë kërkim të palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit, në funksion të analizës ligjore të kërkimeve objekt padie, çmon të marrë në shqyrtim elementet e institutit të begatimit pa shkak referuar dispozitave ligjore të K.Civil.

Konkretisht, neni 655 i Kodit Civil parashikon se: *"Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit."*

Neni 658 i kodit Civil parashikon se: *"Padia për begatimin pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar."*

Begatimi pa shkak nënkupton si shtimin e pasurisë së një personi ashtu edhe kursimin e asaj që duhej të shpenzohej dhe nuk u shpenzua, realizuar kjo në dëm të një personi tjetër. Gjykata çmon se bazuar në nenin 655 të Kodit Civil, që të ndodhemi para institutit juridik të

begatimit pa shkak duhet të ekzistojnë disa kushte pozitive dhe negative (*kumulative*), te cilat janë: a) *Një person duhet të jetë pasuruar dhe një tjetër të jetë dëmtuar*; b) *Pasurimi i një personi duhet të rrjedhë nga dëmtimi i personit tjetër (lidhja shkakesore)*; c) *Pasurimi nuk duhet të ketë ndodhur në bazë të një shkak të ligjshëm (pra, të mungojë një shkak i ligjshëm ose ai të ketë ekzistuar dhe të jetë shuar në një periudhë të mëvonshme)*.

Referuar përcaktimeve sa sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, në rastin objekt gjykimi, çmon se jemi para një mosmarrveshje doganore dhe ligji material i cili rregullon çështjen objekt shqyrtimi është Kodi Doganor dhe dispozitat zbatuese të tij. Në këtë kuptim pala paditëse nuk ka një interes legjitim për të kërkuar kthimin e shumës 3.491.036 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë për pagesë të padetyruar.

Referuar sa sipër, shkaqet e parashtruara nga pala paditëse shoqëria '██████████' shpk për kundërshtimin e vendimit nr.433, datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si të tilla të papranueshme.

Në këto rrethanat Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr.433, datë 29.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duhet të lihet në fuqi.

#### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykata

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 433 datë 29.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, sot më datë 16.12.2019.

GJYQTAR  
Bernina KONDI

d.v

GJYQTAR  
Enkelejda METALIAJ  
(SOFTA)

d.v

GJYQTAR  
Kastriot SELITA

d.v

Vërtetohet njësa me origjinalin  
Leonard STRATAJ

